



In medias res

Zhvillimi i kurrikulit – elementet kurrikulare

*“Dija buron nga mjedisi në të cilin njerëzit gjejnë veten”¹
“Mësuesi duhet të jetë një lloj profeti- ai duhet t’i përgatisë nxënësit e tij për një botë të ardhshme,
për botën e tridhjetë apo pesëdhjetë viteve më vonë”
Gordan Brown*

Në qartësimet e deritashme kemi konstatuar se hulumtimi dhe identifikimi i nevojave të qytetarëve si dhe studimi i kërkesave që dalin nga zhvillimi i shkencës, teknologjisë, informacionit janë të domosdoshme. Por nevojat dhe aspiratat nuk janë diçka statike. Ato ndryshojnë. Gjithashtu nevojat dhe aspiratat varen edhe nga individët dhe shoqëritë e caktuara, andaj ato janë të shumta dhe përherë duhet të identifikohen. Është e njohur se shoqëritë dhe individët me pritshmëri të lartë arrijnë edhe rezultate më të larta.

Nga këto konstatime, natyrshëm del pyetja “Çfarë duhet të përfshihet në të mësuar”. Përgjigja në këtë pyetje është komplekse dhe e vështirë, sepse duhet përcaktuar qartë nevojat e mëdha dhe të shumta edhe të qytetarëve dhe të shoqërive. Kjo çështje bëhet edhe më e ndërlikuar kur duhet të përgjigjemi në pyetjet se çfarë dijesh u duhen fëmijëve të sotëm për një botë të ardhshme pas tridhjetë e ca viteve. Këto kërkesa për hartimin dhe zhvillimin e kurrikulave shtrojnë nevojën që zhvillimi i tyre të udhëhiqet me specialist të profileve të ndryshme e jo siç o ndodh në vendet që janë duke kaluar transicionin. Për hartimin e kurrikulave nevojiten shkencëtarët e shkencave të: filozofisë, sociologjisë, psikologjisë, ekonomisë, medicinës, teknologjisë, drejtësisë, futurologjisë etj. Megjithatë, bazën shkencore të hartimit të kurrikulave e bënë shkencat e edukologjisë – pedagogjisë dhe disiplinat e saj siç janë: didaktika e përgjithshme dhe speciale, metodologjia e kërkimeve shkencore, pedagogjia konstruktiviste, pedagogjia maksimaliste, pedagogjia e paqes, pedagogjia e edukimit multi/ndër/kulturor, dokimologjia, pedeutologjia etj. Pa mbështetjen e shkencëtarëve të këtyre profileve, kurrikulat asnjëherë nuk do të jenë në gjendje të japin një përgjigje në pyetjen e parashtruar “Çfarë duhet të përfshihet në të mësuar”

Dijet, si receta të cilat ne i përdorim sa herë që duhet ta kryejmë një punë apo të zgjedhim një problem, duhet të jenë të organizuara dhe të përcjella me instruksione për mënyrën e përvetësimit të tyre. Që kurrikulat të jenë funksionale ato më shumë duhet të orientohen në dije gjenerike, dije që nxënësit do të duhen në të ardhmen. Por, për të realizuar këtë, kurrikulat duhet të orientohen në zhvillim të aftësive dhe të kompetencave shumëdimensionale për llojet e ndryshme të nxënësve.

Që kjo të arrihet është e domosdoshme të përcaktohen elementet përbërëse të kurrikulave të cilat jo rrallë quhen përbërës kurrikular.

Këto elemente kurrikulare janë:

- Vizioni kurrikular
- Qëllimet kurrikulare
- Objektivat e përgjithshme kurrikulare
- Objektivat specifike kurrikulare
- Përmbajtjet kurrikulare
- Zbatimi kurrikular
- Metodologjia e mbikëqyrjes, monitorimit dhe të vlerësimit të zbatimit të kurrikulave
- Metodologjia e rinovimit - freskimit dhe të aktualizimit të kurrikulave

Në vazhdim do të shkruajmë veç e veç për secilin element kurrikular

Shkroi: Halim Hyseni

¹ Orstein, A&Hunkin, F. (2003) Kurrikula. Bazat, parimet dhe problemet. Instituti i Stidimeve Pedagogjike, Tiranë, f.312

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Programi i granteve për zhvillimin e shkollave

■ Në rundin e parë të projektit Grantet për zhvillim e shkollave janë përzgjedhur të marrin pjesë 109 shkolla nga mbarë Kosova. Pas përfundimit të trajnimit për hartimin e Planit Zhvillimor të Shkollës (PZhSh) që është mbajtur në fund të nëntorit, këto shkolla filluan hartimin e PZhSh të shkollave të tyre. Prezantimet e planeve të përgatitura shkollore u bë gjatë punëtorive 1-ditore që u organizuan në baza rajonale më 14 dhjetor në Prizren dhe Ferizaj, ndërsa më 15 dhjetor në rajonet e tjera të Kosovës. Gjatë prezantimeve, trajnerët dhe pjesëmarrësit ishin aktiv në ofrimin e ideve për përmirësimin e planeve të prezantuara. Në fund të punëtorive u kërkua që shkollat të finalizojnë brenda javës planet zhvillimore të tyre.

■ Më 8 dhjetor 2010, për Bashkëpunëtorët Profesional të Terrenit (BPT) u organizua një trajnim 1-ditor për rregullat dhe procedurat e prokurimit që do të aplikohen në kuadër të projektit GZhSh.

■ Më 20 dhjetor në KEC u organizua një punëtori 1-ditore për hartimin e një kornize për monitorimin e zbatimit të projekteve shkollore. Në punëtori morën pjesë përfaqësues të ekipit koordinues të projektit, përfaqësues të këshillit për aprovimin e granteve shkollore, përfaqësues të DKA dhe drejtorë të shkollave.

■ Pas finalizimit të PZhSh, përfaqësuesit e shkollave pjesëmarrëse në rundin e parë morën pjesë në trajnimet e organizuara për hartimin projekt propozimeve. Këto trajnime u organizuan në baza rajonale nga 21-26 dhjetor 2010.

Pas përfundimit të trajnimit u kërkua që secila shkollë në bashkëpunim me BPT të hartojë nga një projekt propozim për t'u financuar nga projekti i GZhSh. Hartimi i projekteve është realizuar gjatë muajit janar.

■ Më 20-28 janar në 7 rajonet e Kosovës është mbajtur dhe trajnimi për prokurim për të gjitha shkolla e përzgjedhura. Trajnimi është udhëhequr nga specialistët e prokurimit të projektit IDEP.

■ Finalizimi i projekt propozimeve për 109 shkolla e përfshira ka përfunduar më 31 janar 2011. në javën e parë të shkurtit Ekipet Komunale për Grantet Shkollore do të bëjnë vlerësimin e projekteve shkollore dhe ato që përmbushin kriteret do të rekomandohen për aprovim nga KAGSh.

KOSOVISION Contest

■ Gjatë muajit dhjetor u zhvilluan aktivitetet përmbyllëse të fazës së parë, përkatësisht gjysmëvjetorit të parë. Pasi që u shpallën fituesit në regionet e Kosovës, u organizua edhe Ceremonia qendrore e projektit ku edhe një herë u shpallën fituesit e këtij viti në projekt. Ceremonia u organizua në Sallën e Kuqe në Pallatin e Rinisë në praninë e rreth 500 mysafirëve, ku prej tyre 250 ishin nxënës të klasave fituese. Përveç programit artistik të organizuar, në këtë ceremoni u shpallën edhe tre fitues me short të cilët do të kalojnë një pushim të shkurtë dimëror në Brezovicë. Klasat fituese me short janë: "Mileniumi i Tretë", Prishtinë /klasa V1, "Hilmi Rakovica", Prishtinë /klasa V 3 dhe "Xhavit Ahmeti", Hodonoc/ Klasa V1.

Pas kësaj ceremonie është organizuar edhe një takim përmbyllës me stafin lokal dhe koordinatoret e projektit për të bërë një vlerësim të fazës së parë të projektit KOSOVISION CONTEST dhe për të përgatitur kalendarin e aktiviteteve për

fazën e dytë e cila fillon në janar të vitit 2011.



■ Gjatë muajit janar, janë bërë përgatitjet e para për fazën e dytë të projektit. Gjatë këtij muaji kanë filluar trajnimet e mësimdhënësve fitues për mënyrën e realizimit sa më të mirë të projektit. Këto trajnime do të vazhdojnë edhe gjatë muajit shkurt.

Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të projektit “Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit”, financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtij muaji dhjetor dhe janar janë zhvilluar këto aktivitete:

1. Monitorimi i tretë është zhvilluar në të gjitha shkollat e synuara dhe shkollat kontroll. Futja e të dhënave nga pyetësorët është bërë dhe është dorëzuar. Udhëheqësit e projektit kanë përgatitur edhe raportin e monitorimit të tretë për regionin e Prishtinës dhe të Prizrenit.

2. Cikli i dytë i trajnimeve për nxënës ka përfunduar. Nxënësit përveç njohurive të fituara gjatë trajnimit tre ditor, janë pajisur edhe me certifikata për pjesëmarrje.

Këta nxënës do të angazhohen për punë të mëtutjeshme në projekt, me fillim të gjysmë vjetorit të dytë.

■ Gjatë muajit janar, është punuar kryesisht në hartimin e raportit përmbledhës për vitin e dytë të projektit. Ky raport do të dërgohet në muajin shkurt për të vazhduar më tej me aktivitetet e parapara për gjashtëmuajorin e fundit të projektit.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

■ Në kuadër të këtij projekti gjatë muajit shtator janë organizuar këto aktivitete:

1. Është finalizuar strategjia për bashkëpunim në mes të organizatave partnere në Projekt. Pasi që gjatë hartimit të strategjisë, përfaqësuesit e organizatave partnere u dakorduan që APREME si një trup të hyjë nën ombrellën e NEPC-it (Network of Educational Policy Centers), projekti dhe strategjia u prezantuan gjatë Asamblesë së Përgjithshme të NEPC-it, më 4-7 dhjetor 2010.

2. Në kuadër të komponentës 4 të Projektit, Iniciativat Lokale, shkollat janë vizituar disa herë gjatë dhjetorit dhe janarit. Poashtu është mbajtur një punëtori një ditore për tu ndihmuar atyre gjatë procesit të zbatimit të projekteve.

Pjesëmarrja e prindërve në vendim marrje në shkollë

■ Gjatë muajit dhjetor kanë përfunduar të gjitha trajnimet e parapara për pjesëtarët e Këshillave të prindërve në Mitrovicë, Prishtinë, Gjilan, Gjakovë, Pejë dhe Prizren. Pjesëmarrësit morën pjesë në trajnimet për Drejtësinë shoqërore dhe E

drejta për përfaqësim publik - Avokimi. Pas përzgjedhjes së një grupi prej 17 veta nga pjesëtarët në trajnimet paraprake, u organizua punëtorja për hartimin politikave. Punëtorja u organizua në lokalet e KEC me datat 14, 15, 16 janar. Si rezultat i kësaj punëtorie u hartuan tre politika:

- 1 Rritja e kohëzgjatjes së qëndrimit të nxënësve në shkollë.
2. Roli i prindërve në vendimmarrje në shkollë.
3. Siguria e nxënësve në shkollë.


Hap pas Hapi

■ Gjatë kësaj periudhe u organizuan disa trajnime të programit Hap pas hapi për shkollat fillore

Istog	kl. I	28,29,30 dhjetor
Pejë	kl. IV	4,5,6 janar, grupi I
Pejë	kl. IV	4,5,6 janar, grupi II
Gjakova	kl. II	22,23,29 janar
Prishtina	Kl. IV	28,29,30 janar

Parandalimi i dhunës në shkollë

■ Projekti parandalimi i dhunës në shkollë zhvillohet në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit, ndërsa financohet nga UNICEF. Faza e dytë ka filluar me 15 dhjetor 2010. Gjatë kësaj periudhe është rishikuar libri; "Parandalimi i dhunës në shkollë", janë bërë plotësime dhe ndryshime dhe është ribotuar.



■ Është hartuar Korniza për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të projektit, si dhe janë bërë përgatitjet për prezantimin e projektit me datën 10 shkurt 2011.

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

■ Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit të kaluar. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO).

Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

■ Gjatë majit dhjetor dhe janar kryesisht është punuar në përgatitjen e Raportit të Progresit për periudhën shtator-dhjetor 2010.

Ndërsa gjatë muajit janar 2011, janë bërë përgatitjet për punëtoritë e radhës që do të zhvillohen gjatë muajit shkurt.

Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas (EU-SIMRAES)

■ Me 6 janar 2011, është organizuar një punëtori nga KEC ku i ka ftuar të gjitha OJQ-të partnere. Gjatë kësaj punëtorie është prezantuar në mënyrë të detajzuar projekti EU SIMRAES, me theks të veçantë objektivat dhe aktivitetet e këtij projekti. Secili partner është udhëzuar qartë në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Si rezultat i kësaj punëtorie, OJQ-të partnere menjëherë kanë filluar identifikimin e koordinatorëve që do të angazhohen si Koordinatorë të Qendrave Mësimore.



- OJQ-të partnere janë angazhuar në rekrutimin e koordinatorëve të QM-ve. Janë identifikuar dhe rekrutuar të 6-të koordinatorët që do të fillojnë punën prej datës 01 shkurt 2011. Gjithashtu është duke u punuar në gjetjen e ofertave për pajisjen e qendrave me inventar dhe me pajisje tjera.

- Janë duke u bërë përgatitjet për organizimin e trajnimit 5 ditor për koordinatorët e qendrave me qëllim ngritjen e kapaciteteve të qendrave për menaxhim, vlerësim, monitorim dhe raportim.

- Është mbajtur një mbledhje me Enesa Kadic, Udhëheqëse e Divizionit për Komunitete dhe Gjini. Në këtë mbledhje është diskutuar në lidhje me hapat konkretë që do të ndërmerren për themelimin e Bordit për Programin e Bursave.

Përgatiti: Petrit Tahiri